



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Nr. 4015 Prot.

Tiranë, më 02.8 2013

U D H Ë Z I M

Nr. 28, datë 02.8 .2013

PËR
PAJISJEN E NXËNËSVE ME DËFTESË KLASE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 52, pika 2 të Ligjit nr. 69/2012, datë 21. 06. 2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

KREU I

PAJISJA ME DËFTESË KLASE

Pajisen me dëftesë të klasës të gjithë nxënësit e klasave I-VIII dhe klasat X deri te klasa e parafundit e arsimit të mesëm të lartë.

KREU II

FORMATI I DËFTESAVE

1. Format i dëftesave është i njehsuar për të gjitha shkollat.
2. Format i dëftesës duhet të përmbajë këto të dhëna:

Rubrika I

- 1) Stema e Republikës së Shqipërisë.
- 2) Emërtimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
- 3) Emërtimi i njësisë arsimore vendore në juridiksionin e të cilës është shkolla. (Drejtoria Arsimore e _____; Zyra Arsimore e _____).
- 4) Lloji i shkollës (publike, private dhe me kohë të plotë, me kohë të peshme, në distancë).

- 5) Tipi i shkollës (gjimnaz, e mesme e bashkuar, e mesme profesionale, etj.),
Dega_____.
- 6) Emri i shkollës dhe logoja e saj (nëse ka).
- 7) Vendndodhja e shkollës (Qyteti/fshati dhe rrethi)
- 8) Viti shkollor kur lëshohet dëftesa.

Rubrika II (Nxënësi)

- 1) Numri i amzës.
- 2) Emri, atësia, mbiemri.
- 3) Datëlindja (dita, muaji, viti)
- 4) Vendlindja (Qyteti/fshati dhe rrethi)

Rubrika III (Vlerësimet e kurrikulës)

Shënim: Format i pjesës së tretë është i diferencuar për nxënës:

- të arsimit fillor (klasat 1-3);
 - të arsimit fillor (klasat 4-6);
 - të arsimit të mesëm të ulët (klasat 7-9)
 - të arsimit të mesëm i lartë, sipas shkollave (gjimnaz, shkolla profesionale, shkolla artistike, shkolla sportive, etj.);
 - me aftësi të kufizuara.
- 1) Kurrikula ndahet në rubrika sipas shkollave, si:
 - a) lëndët bërthamë, lëndët me zgjedhje të detyruar, lëndët me zgjedhje të lirë;
 - b) lëndët e kulturës së përgjithshme, lëndët teoriko-profesionale.
 - 2) Vlerësimet me notë shoqërohen edhe me fjalë. (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi)
(Vlerësimet janë të periudhave të ndërmjetme, si në klasat I-III, vlerësimet vjetore, përfshirë notat e sesionit të vjeshtës);
 - 3) Për lëndët që vlerësohen edhe me kredite, shënohet numri i krediteve, koeficienti përkatës, numri përkatës i pikëve.

Rubrika IV

- 1) Nota mesatare vjetore.
- 2) Numri i pikëve për kredit. (kur ka)

Rubrika V (Mungesat)

Numri i mungesave, të ndara në "Të arsyetuara" dhe "Të paarsyetuara":

Rubrika VI (Karakteristikat e nxënësit)

Karakteristika e nxënësit. (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi)

Rubrika VII

- 1) Kalimi ose mbetja në klasë.
- 2) Klasa për të cilën jepet dëftesa (Klasa e parë, ... e njëmbëdhjetë).
- 3) Data e lëshimit të dëftesës.
- 4) Emri dhe firma e mësuesit kujdestar të klasës.
- 5) Emri dhe firma e drejtorit të shkollës.
- 6) Vula e shkollës.


Rubrika VIII

Shënimi për notën më të vogël dhe atë më të lartë kaluese, për kuptimin e kreditit dhe të pikëve.

Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe njësitë arsimore vendore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI


MYQEREM TAJ

